



DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI MUJOR I
SËMUNDSHMËRISË
INFEKTIVE
(Pasqyra 14 Sh)

JANAR, 2026

Buletini Mujoy i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP) dhe bazohet në të dhënat e raportuara përmes Pasqyrës Mujore 14 Sh dhe Sistemit të Informacionit të Sëmundjeve Infektive (SISI). Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat individuale të raportuara në SISI për muajin janar 2026 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH), të cilat krahasohen nga Departamenti i Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), dhe plotësohen edhe me të dhënat e laboratorëve të referencës në ISHP. Ky raport paraqet kryesisht rastet e konfirmuara, dhe në disa raste edhe ato të dyshuara dhe të konfirmuara.

1. Sëmundjet diarreike

Për muajin janar incidenca e sëmundjeve diarreike është 281.46 raste për 100,000 banorë. Gastro-enteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha bashkitë e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike me incidencë 280.8/ 100000 banorë. NJVKSH Shkodër mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës dhe Shigelozës për muajin janar 2026 në nivel kombëtar.

Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin janar 2026
(Incidenca raste/100.000 banorë)


	Raste Janar 2026	Incidenca Janar 2026 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0
Salmoneloza	6	0.25
Shigelozë (Disenteri bacilare)	6	0.25
Toksiko-infeksione alimentare	4	0.14
Gastro-enterite (etiologji e panjohur)	6745	280.79
Sëmundje diarreike në total	6761	281.46

2. Sëmundjet që parandalohen nga vaksina

2.1 Variçela

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit janar 2026 janë raportuar në total 146 raste të dyshuar me variçelë (incidenca 6.03/ 100.000 banorë). Numri më i madh i rasteve është raportuar nga NJVKSH Tiranë me 62 raste. Numri më i lartë i rasteve i përket grup-moshës 1-4 vjeç me 59 raste, grafiku 1.


Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve sipas grup-moshës



2.2 Fruthi

Gjatë muajit janar janë raportuar 22 raste të dyshuara, nga të cilat janë konfirmuar 18 raste nga ana laboratorike me metodën ELISA. Të gjitha rastet janë konfirmuar pranë laboratorit të virologjisë në ISHP. Incidenca në muajin janar është 0.75 raste /100 000 banorë.

Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve të konfirmuara sipas datës së fillimit të rashit



Siç shihet edhe nga kurba epidemike rastet janë të shpërndara gjatë gjithë muajit janar.

Tabela 2. Shpërndarja e rasteve dhe incidenca e fruth sipas bashkive

Bashki	Raste	Incidenca
Burrel	1	5.75
Shkodër	2	1.95
Tiranë	15	2.51
Total	18	0.75

Rastet i perkasin kryesisht bashkisë Tiranë, por incidencën më të lartë e ka bashkia Burrel me 5.75 raste /100 000 banorë.

Të gjitha rastet janë të grup-moshës pediatrike 0-4 vjeç, 16 (88.8%) janë të pavaksinuar dhe 2 (11.2%) raste janë me një dozë vaksine FRP. Të dhënat e vaksinimit janë verifikuar në sistemin elektronik të informacionit mbi vaksinat (SIV).

Gjithashtu 16 (88.8%) raste janë të shtruar në spital, ndërsa 2 (11.2%) prej tyre u ndoqën në rrugë ambulatorie.

Hetimi epidemiologjik i rasteve është kryer nga shërbimi i epidemiologjisë në NJVKSH-në përkatëse, ku janë identifikuar kontaktet dhe janë marrë masat e kontrollit të infeksionit.

Hepatitet virale

3. Hepatiti Viral B (HBV)

Hepatit viral B (HBV)

Në muajin janar janë raportuar 27 raste të konfirmuara me HBV. Incidenca e HBV-së në këtë muaj është 1.12 raste/100 000 banorë në vend.

Prej tyre 16 raste janë të gjinisë mashkull (59.3%) dhe 11 femra (40.7%).

Tabela 3. Shpërndarje e rasteve dhe incidenca (raste/100 000 banore) me HBV sipas bashkive

Bashki	Raste	Incidenca
Dibër	1	1.97
Divjakë	1	4.02
Durrës	2	1.30
Gjirokastër	2	8.59
Lushnjë	2	3.17
Tiranë	19	3.18
Total	27	1.12

Në muajin janar rastet janë të shpërndara në disa bashki (tabela 1), ku numrin më të lartë e ka Tirana me 19 raste, ndërkohë incidenca është më lartë në Gjirokastër me 8.29 raste /100 000 banorë.

Tabela 4. Shpërndarja e rasteve dhe incidenca (raste/100 000 banorë) me HBV sipas grup-moshave

Grup-mosha,vite	Raste	Incidenca
0-4 vjeç		
5-14 vjeç		
15-24 vjeç		
25-44 vjeç	8	1.36
45-59 vjeç	10	2.06
60 + vjeç	9	1.35
Total	27	1.12

Rastet në muajin janar i përkasin grup-moshës adulte mbi 25 vjeç (tabela 1) dhe mungesa e tyre në grup-moshat pediatrike është në sajë të vaksinimit ndaj HBV-së në këto grup-mosha.

Incidenca është më e lartë në grup-moshën 45-59 vjeç dhe përkatësisht 2.06 raste për 100 000 banorë. Të gjitha rastet e konfirmuara, të raportuara janë testuar për arsye diagnoze dhe përmbushin përkufizimin e rastit për hepatit viral akut B.

Hepatiti viral C (HCV)

Në muajin janar janë raportuar 9 raste të konfirmuara me HCV. Incidenca e HCV për këtë muaj është 0.37 raste /100000 banorë.

Pesë raste (55.5%) i përkasin gjinisë mashkull dhe 4 raste (44.5%) asaj femër.

Tabela 5. Shpërndarja e rasteve dhe incidenca me HCV sipas bashkive

Bashki	Raste	Incidenca
Dibër	2	3.94
Lezhë	3	5.84
Pukë	1	16.07
Tiranë	3	0.50
Total	9	0.37

Rastet janë të shpërndara në disa bashki ku incidenca më e lartë i përket bashkisë Pukë me 16.07 raste/100 000 banorë.

Tabela 6. Shpërndarja e rasteve dhe incidenca me HCV sipas grup-moshave (vite)

Grup-mosha,vite	Raste	Incidenca
0-4 vjeç		
5-14 vjeç		
15-24 vjeç		
25-44 vjeç	4	0.68
45-59 vjeç	1	0.21
60 + vjeç	4	0.60
Total	9	0.37


Gjatë muajit janar, rastet janë të shpërndara në grup-moshat adulte mbi 25 vjeç (tabela 2) ku incidenca më e lartë i përket grup-moshës 25-44 vjeç me 0.68 raste /100 000 banorë.

Të gjitha rastet e konfirmuara, të raportuara janë testuar për arsye diagnoze dhe përmbushin përkufizimin e rastit për hepatit viral akut C.


4. Sëmundje seksualisht të transmetueshme dhe HIV/AIDS

Gjatë muajit janar 2026 janë kryer 18 ekzaminime për HIV 18 testime HIV/AIDS (10 femra dhe 8 meshkuj),prej të cilëve rezultojnë pozitivë 7 raste (2 femra dhe 5 meshkuj)

Grafiku 3. Shpërndarja e testimeve për HIV dhe rasteve të konfirmuara sipas gjinisë, në muajin janar 2026.



Shpërndarja gjeografike e rasteve që kanë rezultuar HIV pozitivë është: Tiranë 2 raste (nga të cilët 2 raste janë me shtetësi të huaj), Durrës 2 raste, Fier 1 rast, Korçë 1 rast dhe Vlorë 1 rast



Për sa i përket shpërndarjes sipas grup-moshave: 2 raste i përkasin grup-moshës 25-34 vjeç, 3 raste i përkasin grup-moshës 35-44 vjeç dhe 2 raste i përkasin grup-moshës 45-54 vjeç.

Rastet e konfirmuara kanë ardhur 1 rast nga QSUT (nga Shërbimi Infektiv), 4 raste vijnë nga laboratorë privatë (1 rast – INTERMEDICA, 1 rast – GENIUS dhe 2 raste - Cambridge), 1 rast është referuar si donator gjaku nga QKTGJ, dhe 1 rast është referuar nga NJVKSH Korçë.

Sifiliz janar 2026

Gjatë muajit janar 2026 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 6 raste të konfirmuara me Sifiliz.

Rastet e raportuara, të konfirmuara, janë 5 meshkuj e 1 femër. Shpërndarja sipas grup-moshave është nga 1 rast për grup-moshat, 15-24 vjeç, 25-34 vjeç, 35-44 vjeç, 65-74 vjeç dhe në grup-moshën 45-54 vjeç janë 2 raste.

Rastet vijnë nga bashkitë: Tiranë, Elbasan dhe Vlorë.

5. Tuberkulozi pulmonar dhe ekstrapulmonar

Gjatë muajit janar 2026 janë raportuar gjithsej 9 raste me tuberkuloz (TB). Të gjitha janë raste pulmonare.

Rastet e raportuara me TB pulmonar janë të konfirmuara dhe me sputum pozitiv.

Rastet pulmonare përkatësisht janë: 1 në Tiranë, 1 në Berat, 1 në Krujë, 1 në Shkodër, 1 në Laç, 1 në Vlorë, 1 në Lushnjë dhe 2 raste në Durrës.

Raste ekstrapulmonare dhe raste recidive për muajin janar nuk ka.

Konfirmimet e tyre janë kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria e rrethit përkatës. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, si dhe për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Pothuajse të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse. Siç vihet re dhe nga shpërndarja e rasteve, ato me TB këtë muaj janë të fokusuara kryesisht në Durrës me numër më të madh.

6. Sëmundjet zoonotike

Tabela 7. Shpërndarja e zoonozave në muajin janar 2026, numri total i rasteve dhe incidenca (Antraks, Brucelozë, Leptospirozë, Rikecizioë)

	Janar (raste 2026)	Incidenca (raste/100,000) 2026
Antraks (Plasje)	0	0.00
Brucelozë	8	0.33
Leptospirozë	0	0.00


Për muajin janar janë raportuar 6 raste Brucelozë përkatësisht : 4 nga Gjirokastra dhe 4 raste nga Korça.

7. Sëmundje infektive me transmetim përmes ajrit

7.1 COVID-19 janar 2026


Gjatë muajit janar 2026 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 21 raste të konfirmuara me COVID-19 dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin janar është 0.87 raste /100000 banorë.

Grafiku 4. Shpërndarja e incidencës sipas grup-moshave



Grup-mosha më e prekur për këtë muaj është grup-mosha 0-04 vjeç me incidencë 1.78 raste/100000 banorë, 25-34 vjeç dhe 55-64 vjeç me incidencë 1.6 raste/100000 banorë. Gjatë këtij muaji është shtruar në spital 1 rast i konfirmuar me COVID-19, i grup-moshës 25-34 vjeç.

Grafiku 5. Shpërndarja e incidencës sipas bashkive




Incidencën më të madhe të rasteve e ka bashkia Skrapar e ndjekur nga bashkitë Shijak, Rrogozhinë, Berat, Korçë, Kukës, Elbasan dhe Tiranë.

Gjatë muajit janar 2026 janë raportuar zero raste vdekjeje. Konfirmimi i rasteve është bërë në 95.4% (20 raste), janë konfirmuar në laboratorët e NJVKSH-ve dhe 4.5% (1 rast) është konfirmuar në laboratorin e ISHP-së.

7.2 Grip

Gjatë muajit janar janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 911 raste të dyshuara me Grip, nga të cilat 204 raste kanë rezultuar pozitive dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin janar është 8.49 raste /100000 banorë.

Grafiku 6. tregon shpërndarjen e rasteve sipas tipit të virusave qarkullues. Vërehet mbizotërim i gripit Tipi A, përkatësisht nëntipi AH3.



Në muajin Janar qarkullimi i gripit arriti intensitet mesatar duke paraqitur aktivitet sezonal normal të zakonshëm dhe të pritshëm për stinën, dhe përhapje gjeografike rajonale. Raste me

grip u identifikuan si nga survejanca sentinel ILI-SARI, ashtu edhe nga survejanca virologjike josentinel.

8. Sëmundje të tjera

8.1 Legjionelozë

Për muajin janar 2026 është raportuar 1 rast i konfirmuar në Institutin e Shëndetit Publik me Legionella pneumophila. Rasti është i moshës 51 vjeç, gjinia mashkull, nga Tirana.

INSTITUTI I
SHËNDETIT
PUBLIK

DEKSI